

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Peka: Gjykatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe EULEX-in, e hetuan Kosovën për 24 vite - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/peka-zbardh-detajet-eulex-e-hetoi-kosoven-per-24-vite-nga-93-deri-ne-2017/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 19:34:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 19:31:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3937f7be939d350e4965f235899860e26d2a3d7a89a72ae29574a67366373ae8
TEKSTI	ae3eb1729a6cf5b185dfdbc54e5b3e20f5d69c0091d88c193670f311624f066c
PAMJA	9b3941c040f6380a59eab51b9280ca9e6cd50f3285ed4afde1d38a693d29a273

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ebdfa874742d5a67190982cd3ff208a113446aa24d14166e72beb4dfd5d6ddb8
E MËPARSHMJA	bca563c53908d101db9ec2cc1c10c386cce1b391e16e2111315a5661453ae4df
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ebdfa874742d5a67190982cd3ff208a113446aa24d14166e72beb4dfd5d6ddb8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Lufta në Ukrainë Lufta në Iran SHBA OKB

KOSOVË | LAJM KRYESOR

Peka: Gjykatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe EULEX-in, e hetuan Kosovën për 24 vite



18 Shtator 2026 | 21:31

I ftuar në emisionin Review me Greta Topjana, eksperti i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Avenir Peka, ka analizuar ecurinë e hetimit të krimeve të luftës në Kosovë, duke theksuar se ky proces ka kaluar në katër etapa gjyqësore nga UNMIK-u, EULEX-i e deri te Dhomat e Specializuara.

Ai shpjegoi gjithashtu se si zhvillimet politike dhe juridike ndërkombëtare çuan gradualisht në formimin e strukturës aktuale gjyqësore. Peka theksoi se zanafilla e Gjykatës Speciale lidhet me pretendimet e ish-kryeprokurores Carla Del Ponte dhe raportin e Dick Marty-t, të iniciuar pas trysnisë në Këshillin e Evropës.

Sipas tij, hetimet e prokurorit amerikan Chris Williamson hodhën poshtë pretendimet për “Shtëpinë e Verdhë” dhe trafikimin e organeve, dhe se presioni i madh diplomatik nga BE-ja dhe SHBA-ja çuan në krijimin e gjykatës së katërt, Hagës, për hetimin e krimeve të tjera të supozuara.

“Kemi hetuar të gjitha krimet para, gjatë dhe pas luftës. Kemi hetuar edhe krime lufte, kemi hetuar masakrën e Qyshkut, kemi hetuar edhe krime të kryera ndër shqiptarëve. Kjo gjykatë ka vazhduar, prokuroria dhe gjykata e UNMIK-ut kanë vazhduar deri në vitin 2008 kur Kosova shpalli pavarësinë.

Në atë moment, dimensionin e Bashkimit Evropian në administrimin ndërkombëtar të Kosovës mori përsipër punën që u la në mes gjykata dhe prokuroria ndërkombëtare e UNMIK-ut.

EULEX-i ka vazhduar hetimin e krimeve ashtu si dy gjykatat e mëparshme. Nga viti 2008 deri në 2018-ën vazhdon aktivitetin EULEX-i, por hetimin dhe gjykimin e çështjeve e ka mbyllur. Nga ai moment i hapi rruga gjykatës së re. Gjykata e re, pra është gjykata e katërt, Gjykata Speciale e cila është është gjykata e katërt që merret me hetimin e krimeve të luftës në Kosovë.

Tani, pse erdhëm te kjo gjykatë? Në vitin 2008, ish-kryeprokuroria në Hagë, në Gjykatën për ish-Jugosllavinë, shkruan një libër ku mes të tjerave ngre pretendime për ekzistencën e trafikut të organeve nga UÇK-ja dhe ekzistencën e të ashtuquajturës ‘Shtëpia e Verdhë’ në zonën e verilindjes së Shqipërisë.

Duke qenë se Rusia dhe Serbia kishin influencë të madhe në Asambleen Parlamentare të Këshillit të Evropës, dy deputetë të rëndësishëm, një rus dhe një serb, kërkon miratimin e

LAJMI I FUNDIT

22:32 Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, analisti tregon prapaskenat: Lidhet me konfliktin e Thaçit me Gjermaninë

22:07 Djali i Jakup Krasniqit: Kur të përfundojë dënimin 25-vjeçar, babai mund të mos jetë gjallë

21:29 Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, djemtë e Thaçit, Krasniqit dhe Veselit në protestën e Prishtinës (VIDEO)

SHPËRNDAJE
ARTIKULLIN

21:10 Zelensky pret udhëheqësit botërorë për samitin rajonal në Ukrainë mes pushtimit rus

20:58 Ekskluzive, flet gruaja simbol e eksodit të Kosovës: Si na ndihmoi UÇK-ja të shpëtonim

20:57 Trump deklaroi sërisht se Irani kërkon marrëveshje, teksa SHBA-të po shqyrtojnë hapin e ardhshëm

TESTIM

Këshilli i Evropës, gjatë procesit të rimbledhjes, një ras dhe një serb, kërkuan miratimin e një rezolute që do kërkonte hetime të mëtejshme ndërkombëtare për trafikun e organeve. Këshilli i Evropës e miratoi atë rezolutë dhe ngarkoi një ish-prokuror zviceran, Dick Marty, për të bërë një raport mbi gjetjet pas hetimeve.

Në vitin 2010, Dick Marty dorëzon raportin e tij, një raport fals që mbështet pretendimet e Carla Del Ponte-s për ekzistencën e trafikimit të organeve, të ‘Shtëpisë së Verdhë’ dhe krimeve të tjera. Në atë moment, Bashkimi Evropian ngre një njësi hetimore të drejtuar nga një prokuror amerikan, Chris Williamson, i cili njihte mirë Kosovën sepse kishte qenë drejtor i Departamentit të Drejtësisë atje.

Kanë përdorur teknologjinë më të avancuar për të bërë analizat e ADN-së, jo vetëm në muret e shtëpisë, por edhe në oborr, madje kanë marrë edhe kocka kafshësh për të analizuar dhe nuk doli asgjë.

Në vitin 2014, ai prodhoi raportin e vet ku hidhte poshtë pretendimet për trafikun e organeve dhe ekzistencën e ‘Shtëpisë së Verdhë’. Në këtë moment mbyllet cikli i pretendimeve të Carla Del Ponte-s dhe Dick Marty-t.

Bashkimi Evropian nuk u mjaftua me kaq, por duke qenë se në raport thuhej se rezultoi të jenë kryer krime të tjera, kërkoi që të avancohet më tej dhe të ngrihet një gjykatë e veçantë kosovare që të hetonte këto krime. Presioni ndaj autoriteteve të Kosovës ishte i jashtëzakonshëm, presioni amerikan ishte shumë i madh, presioni i BE-së po ashtu. Ndikim të madh kishte sigurisht Serbia dhe shtetet që janë më afër kauzës së Serbisë në rajon”, u shpreh ai.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | LAJMI I FUNDIT | RAJONI | REVIEW

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, analisti tregon prapaskenat: Lidhet me konfliktin e Thaçit me Gjermaninë

I ftuar në “Review” me Greta Topjanën, analisti Indrit Vokshi solli një tjetër interpretim mbi atë që, sipas tij, fshihet pas dënimit të ish-krerëve të...

22:32 | 18/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | RAJONI | REVIEW

Djali i Jakup Krasniqit: Kur të përfundojë dënimin 25-vjeçar, babai mund të mos jetë gjallë

Djali i Jakup Krasniqit, Altin Krasniqi, tha se babai i tij, 76 vjeç, mund të mos jetë gjallë kur të përfundojë dënimin 25-vjeçar të dhënë...

22:07 | 18/09/2026

KOSOVË | LAJM KRYESOR | LAJMI I FUNDIT | RAJONI

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, djemtë e Thaçit, Krasniqit dhe Veselit në protestën e Prishtinës (VIDEO)

Në Prishtinë është zhvilluar dita e tretë e protestës pas vendimit të Gjykatës Speciale në Hagë për dënimin me gjithsej 81 vite burg të katër...

21:29 | 18/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.